



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.05.2026**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi se, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 25.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Kjo është mbledhja e **pestë** e rregullt dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza, 2025 - 2031;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe të rrugicave në komunën e Rahovecit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të draft-rregullores për Shërbime Publike 01 nr.2917, i datës 26.10.2018;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit të ankesave, kundër vendimit të komisionit ad hoc për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe;
9. Shqyrtimi i informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth rregullimit të rrugëve në komunën e Rahovecit për vitin 2025;
10. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

Kryesuesi: Atëherë, pas leximit të rendit të ditës prej 10 pikave, po e hapim debatin. A e keni pranuar materialin me kohë, nëse dikush ka vërejtje?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit! Materialin e pikës së shtatë nuk e kemi pranuar: Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të draft-rregullores për Shërbime Publike 01 nr.2917, i datës 26.10.2018.

Kryesuesi: Kjo rregullore do të shfuqizohet dhe besoj që arsyetimin do ta jep drejtoria apo zyrtari ligjor. Atëherë, përveç këtyre pikave të rendit të ditës, i kemi edhe dy pika shtesë: Vendimin për lirim nga pagesa e taksave për leje ndërtimore dhe legalizim dhe pika e dytë shtesë është Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të draft-

dokumentit të planifikimit hapësinor “Harta Zonale e Komunës së Rahovecit, 2026-2034”. Kërkoj nga ju që së pari t’i votojmë pikat shtesë, por së pari nëse keni ndonjë diskutim rreth rendit të ditës?!

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë, kolegë anëtarët të kuvendit, përfaqësues të KFOR-it, qytetarë. Kërkoj një informatë rreth një lajmi që ka qarkulluar për parkun industrial në Opterushë dhe besoj që deri në fund të seancës kryetari të na përgatit informacionet rreth vlerës së investimeve të bëra nga komuna deri në këtë fazë. Është shqetësuese se si të anulohet një kontratë e tillë në Opterushë! Njëjtë ka ndodhur edhe me shtratin e lumit në 5 fshatra dhe komuna veçse ka filluar me marrëveshje mirëkuptimi, ndërsa ministria i ka anuluar këto procedura. Qytetarët e komunës së Rahovecit nuk e meritojnë këtë qasje, meritojnë projekte serioze dhe projekte që kryhen me kohë. Te pika e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale. Kërkoj që të respektohet rregullorja dhe këtu të jepet një zotim që kryetarët e këshillave lokalë të marrin pagesë. Rregullorja e ministrisë dhe ajo e komunës e përcakton specifikisht që mandati duhet të jetë me pagesë konform dispozitave ligjore, njëjtë sikur anëtarët e komiteve tjera.

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigzon! Me mirëkuptim, këtu t’i diskutojmë vetëm çështjet që i përkasin rendit të ditës. Në pikën e dhjetë të rregullt mund të diskutojmë edhe çështje të tjera. Nëse nuk ka dikush tjetër diçka, po i vendosi në votim 2 pikat shtesë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota votohen pikat shtesë. Tani po e vendosi në votim rendin e ditës në tërësi. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota miratohet rendi i ditës për sot, unë do të them “unanimisht”.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka kush diçka rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet procesverbali.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza, 2025 – 2031:

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për kryetarin, drejtorët, anëtarët e kuvendit, monitorues nga LMT dhe ju të pranishëm. Ky dokument është pjesë e një projekti në bashkëfinancim me Bashkimin Evropian me Haraçinë. Ky projekt është pjesë e strategjisë, është hartuar nga zyrtarë të BE-së, si dhe pjesëmarrës ka qenë edhe GIZ-i gjerman. Komuna e Rahovecit e ka krijuar grupin punues, i cili e ka shqyrtuar këtë dokument me të gjitha hapat ligjorë. Ky dokument përmban gjendjen faktike, infrastrukturën publike, mbrojtjen e mjedisit, si dhe konsultimet publike që janë realizuar me qytetarë. Jam këtu për të gjitha pyetjet tuaja.

Enis Durguti: Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë. Urime festa e Kurban Bajramit të gjithëve. Realisht kjo është strategji shumë e rëndësishme, sepse lidhet drejtpërdrejt me shëndetin publik, me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin afatgjatë të komunës së Rahovecit. Ky është i vetmi dokument pak më i detajuar nga strategjitë që deri më tani i kam lexuar, kështu që është pozitive. Problemi qëndron në atë se vetë strategjia po e pranon se 95% e popullsisë e komunës së Rahovecit ka rrejt kanalizimi dhe njëkohësisht e gjitha kjo derdhet në lumin e bardhë pa u trajtuar, shkon direkt. Mbi 925 metër kub shkarkohet çdo vit pa trajtim në lumin Drini i Bardhë. Problemi nuk është veç në infrastrukturë, por te trajtimi real. Para se të shkoj te pyetjet, dokumenti më hershëm 2018-2020, mendoj që ka dështuar ai projekt dhe pyetje është: pse në vitin 2026 po miratojmë strategji të re, ndërsa në vitin 2018-2020 (nëse nuk gaboj) ka qenë pak a shumë i njëjti projekt. A ka dështuar ky projekt, a kanë munguar fondet dhe a është implementuar ndonjëherë kjo strategji e vitit 2018-2020? Pyetjet: Cili është projekti i parë konkret që do të fillojë me punime reale në terren? Strategjia i sheh diku 17.5 milionë investime dhe sa prej këtyre mjeteve janë siguruar nga IPA, BERZH-i, fondet e BE-së, apo nga donatorët e tjerë? A është nënshkruar ndonjë marrëveshje reale? Impianti kryesor? A ekziston ndonjë afat konkret që ky impianti të ndërtohet në qytetin e Rahovecit? A do të ketë raportim periodik në kuvend për progresin dhe shpenzimet e kësaj strategjie? Të nderuar kolegë të ekzekutivit, kemi parë shumë dokumente dhe shumë strategji të prezentuara, por nuk kemi

parë rezultate konkrete. Prandaj, shpresoj që kjo strategji nuk do të mbetet si dokument administrativ, apo vetëm formalitet, por kërkoj që të kthehet në projekt real, me afate, financim konkret dhe përgjegjësi institucionale. Parimisht e mbështes këtë strategji, por gjithsesi duhet të vazhdojë informimi i qytetarëve në kuvend rreth implementimit, afateve, financimin dhe progresin në terren.

Bujar Mustafa: Përshëndetje të gjithëve dhe urime festën! Te tabela 24 e këtij dokumenti “mbulimi me kanalizim”, ku thotë që të gjitha vendbanimet kanë qasje në kanalizim, por situata në terren thotë ndryshe. Në Celinë ka lagje që nuk kanë qasje hiç, në Pataqan gjithashtu gypi kryesor derdhet në fushë. Në disa pika thuhet që do të ketë investime në kanalizim, ndërsa në disa pika të tjera jo. A mund të ma sqarojë dikush?

Lirigzon Kastrati: Këtu po e shoh që, për miratimin e strategjisë për menaxhimin e ujërave të zeza në komunën e Rahovecit për vitin 2025-2031, ndërsa ne jemi në vitin 2026! Në raport, në një vend përmendet që do të ndërtohen 4 impiante, në një vend 3 impiante, diku 4 kolektorë, duku 3. Është mirë ta dimë saktë!

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë anëtarë të kuvendit. Gjithashtu edhe për neve kjo strategji është shumë e rëndësishme për komunën e Rahovecit, por duke marrë parasysh koston e implementimit të kësaj strategjie që do të zgjidhte një problem shumë të madh për të mirën e qytetarëve, komuna e ka të papërballueshme implementimin e kësaj strategjie. Çka ka bërë komune me strategjinë e kaluar, që e përmendi edhe kolegu?! Çfarë veprime ka bërë komuna që të kërkoj fonde prej organizatave ndërkombëtare, qeverisë, apo edhe prej BE-së? Në këtë strategji, gjithashtu ka pjesë ku komuna mund të veprojë, te rrjeti i dobët i kanalizimit. Komuna mund ta rregullojë një gjë të tillë. Një pyetje tjetër: Çka mund të bëjë komuna për shtëpitë private që nuk kanë kyçje në kanalizim?

Përparim Krasniqi: Po e filloj nga Enis Durguti. Komuna e Rahovecit asnjëherë nuk ka pasur strategji të këtij lloji. Strategjia e ujërave të zeza ka qenë nga niveli nacional, por asnjëherë nga niveli lokal. Sa i përket trajtimit, impiantit dhe fizibilitetit, ne e kemi një projekt të mëhershëm për kolektorët e komunës së Rahovecit, gjithashtu e kemi pasur edhe një projekt-propozim për impiante. Këto kërkesa adresohen çdo vit në ministri të linjës, sidomos në atë të Mjedisit, mirëpo fatkeqësisht asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje, për shkak të kostos së lartë që e ka ky investim. Raportimi do të jetë i përvitshëm. Në këtë strategji kemi edhe investime, si p.sh: është i paraparë kolektori në dy anë të përrockës nga qyteti në drejtim të Fortesës dhe shkarkimi do të bëhet aty ku është i paraparë vendi për impiant në Krushë të Madhe. Kjo strategji është pjesë e projektit me Bashkimin Evropian, të cilët kriter kryesor për fonde e kanë këtë strategji. Bujar, komuna e Rahovecit, sipas Entit të Statistikave është komuna e parë në nivel vendi që ka trajtim të ujërave të zeza në të gjitha vendbanimet. Mund të kemi trajtim të ujërave të zeza çdo vit, sepse lagjet e re mund të shtohen çdo vit dhe kërkesat janë të vazhdueshme. Defrim, rregullorja për shërbime publike e trajton me kujdes se ku duhet të merret pëlqimi përmes K.R.U Gjakovës për kyçje në kanalizim. Komuna e Rahovecit bën investime në prona publike dhe jo në ato private, mirëpo, ne e kemi një projekt për furnizim me gypa që qytetarët tanë, që përmes një kërkesë mund të furnizohen edhe për prona private për t’u kyçur në rrjetin kryesor të kanalizimit publik. Lirigzoni pyeti për kolektorët: Po, ka vende që do të bëhet 3 kolektorë dhe ka vende që do të bëhet 4 kolektorë, sepse konfiguracioni i qytetit ndahet në 3-4 zona. Sa i përket atij “gabimi” te viti 2025, e kemi bërë ashtu sepse dokumenti është punuar në vitin 2025.

Kryesuesi: Faleminderit! Do të sqarohemi edhe me ministri, nëse duhet të jetë 2025-2031, apo 2026-2031.

Bujar Mustafa: Pyetja ime ishte se a do të ketë zgjerim të rrjetit të kanalizimit për lagjet që nuk kanë qasje në kanalizim prej shekullit të kaluar, sidomos në Celinë?! Gjithashtu në Pataqan të Poshtëm, fshati ka qasje në kanalizim, por gypi kryesor derdhet në fushë dhe mbi 15 hektarë tokë janë të papunueshme dhe të pakalueshme për këtë punë. A janë të përfshirë në këtë projekt?!

Përparim Krasniqi: Bujar, ndoshta nuk e din, por Pataqani i Poshtëm e ka të përfunduar gropën septike, pjesë e projektit me BE-në dhe tani shkarkimi bëhet aty në gropë septike.

Kryetari: Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, anëtarët e kuvendit, mediat, KFOR-in. Strategjia për ujërat e zeza nuk mund të zbatohet plotësisht nga një komunë e vetme, sepse është e ndërlidhur me plot zhvillime, masa e veprime që janë të lidhura me qeverinë dhe parlamentin. Ne, çdo herë kemi marrë hapa që të kemi fokus më të madh në trajtimin e ujërave të zeza, sepse kanalizimi i ujërave të zeza është diçka tjetër. E vërtetë është që janë bërë disa zgjidhje me disa gropa septike, të cilat konsiderohen të mira dhe të qëndrueshme. Tani, Komuna e Rahovecit e ka një projekt tjetër për ndërtimin e gropave septike, të cilat janë me standarde të larta dhe kur hyn uji i ndotur në gypa, 70% e tij del i pastër. Është përmendur dikur në 2017 kinse është futur impianti i ujërave të zeza në Rahovec dhe kur kemi ardhur në pushtet e kemi mësuar që nuk ka qenë e vërtetë. Kuvendi i komunës e ka miratuar një vendim, mirëpo atje nuk ka ecur tutje dhe kemi ngelur këtu ku jemi. Ne vazhdimisht do të insistojmë që të zbatohet strategjia e ujërave të zeza, mirëpo kemi nevojë edhe për ndihmën e shtetit dhe të donatorëve. Bujar, në pyetjen tënde, në Pataqan është bërë gropa septike dhe është zgjidhur ky problem në 6 vende. Ka lagje që janë pa kanalizim, sepse ka disnivele dhe për këtë akoma kemi punë për të bërë. Kësaj radhe e kemi më të vështirë, sepse deri më tani ende nuk na kanë lëshuar buxhetin për investime kapitale dhe tani për tani jemi të bllokuar. Ju ftoj ta miratoni këtë strategji.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Po e vendosi në votim strategjinë. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimisht miratohet strategjia.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026:

Kryesuesi: Nuk po e shoh përfaqësuesin e Komitetit për Komunitete, por besoj që materialin e keni pare dhe duhet që formalisht ta vendosim në votim. Nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike?

Lirigzon Kastrati: Kryesues, është mirë që dikush ta prezantojë këtë pike, sepse edhe rregullorja e kuvendit thotë që nëse nuk ka përfaqësues prej këtij komiteti, barra e përgjegjësisë për prezantim bie te ti.

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigzon! Zakonisht në KPF janë shefat e grupeve dhe aty është diskutuar kjo pike. Nëse dëshironi unë mund ta lexoj planin. Nëse jo, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, unanimisht miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale:

Afrim Dina: Faleminderit, kryesues! I nderuar krytar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit. Para vetes e keni propozim-vendimin për formimin e komisionit për udhëheqjen e punës në terren për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Në këtë komision janë 7 anëtarë, prej tyre 4 nga kuvendi, 1 nga ekzekutivi, 1 nga shoqëria civile dhe një përfaqësues nga vendbanimi ku mbahet takimi për zgjedhjen e kryetarëve.

Kryetari: Sa i përket temës së Lirigzonit rreth pagesave të kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane: Po, është e vërtetë që në disa qytete, si në Prishtinë e Pejë, kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane paguhen. Ne kemi tentuar të gjejmë mënyra të pagesave me mëditje. Dy apo tri herë u kemi ndihmuar dikujt e dikujt, e më pas u është ndalur pensioni, sepse kanë qëlluar të jenë veteran. Sidoqoftë, me një plotësim-ndryshim të rregullores në të ardhmen mund ta shohim, sepse edhe unë jam “për”.

Lirigzon Kastrati: Kryetar, për çka propozim-ndryshimi i rregullores? Për kompenzim? Neni 14 i kësaj rregullore e thotë specifikisht: Kompenzimi i kryetarëve të këshillave lokale duhet të bëhet nga buxheti i komunës. Këtu mund ta japësh vetëm një zotim që në buxhetin e vitit të ardhshëm do t'i mbulonin këto kompenzime. Ligji e thotë që të paguhen në 6 mbledhje dhe jo tërë vitin kalendarik. Pra, kjo është kompenzim dhe jo pagë e rregullt.

Kryetari: Më duket isha shumë i saktë. Ne kemi dhënë mëditje dhe na ka dalur telashe, sepse njerëzit që kanë marrë mëditje për shkak të ndalesës tjetër kanë thënë që mos t'ju lëshojmë. Shumica e kryetarëve të këshillave

deri tani kanë qenë të përfshirë në lista të punësimit dhe për atë e thash plotësim-ndryshim, sepse mund ta bëjmë më specifikisht, sikurse me vendim të kuvendit që i kemi bërë pagesat për komisione.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! A ka diskutues të tjerë? Nëse jo, atëherë i kërkoj propozimet nga shefat e grupeve politike.

Sarandë Sallteku: AAK, e propozojmë Berat Durakun!

Enis Durguti: LDK, e propozojmë Lirigzon Kastratin!

Vlora Vuciterna – Qmega: Fillimisht ju uroj Bajramin të gjithëve. Nga LVV propozojmë Jusuf Dërmala!

Flutura Thaqi: PDK, e propozojmë Melinda Oruqi – Iska!

Kryetari: Nga ekzekutivi e propozoj Norë Boshnjakun dhe nga shoqëria civile, Adelinë Paqarizi.

Kryesuesi: Atëherë, katër anëtarë nga kuvendi: Berat Duraku, Lirigzon Kastrati, Jusuf Dërmala dhe Melinda Oruqi – Iska. Nga ekzekutivi është Nora Boshnjaku dhe nga shoqëria civile, Adelina Paqarizi dhe pastaj do të jetë edhe një përfaqësues nga vendbanimi apo lagjja urbane. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Unanimisht miratohet ky vendim.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale:

Afrim Dina: Kjo pikë lidhet me pikën paraprake dhe ka të bëjë me miratimin e vendimit për komision të ankesave rreth procesit të zgjedhjes së këshillave lokale. Ky komision përbëhet nga 3 anëtarë nga kuvendi.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Janë të përcaktuar partitë politike që i bëjnë propozimet. Ju ftoj për propozime.

Berat Duraku: AAK, e propozojmë Florida Bajraktarin!

Lirigzon Kastrati: LDK, e propozojmë Hazbije Shalën!

Defrim Kafexhiu: LVV, e propozojmë Zana Qantën!

Kryesuesi: Ky është diskriminim, sepse nuk e propozuat asnjë mashkull. Sido që të jetë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Unanimisht miratohet ky vendim.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe rriemërtimin e rrugëve dhe të rrugicave në komunën e Rahovecit:

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë, pjesëmarrës. Para jush e keni vendimin për formimin e komisionit për emërtimin dhe rriemërtimin e rrugëve dhe rrugicave. Ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve, 3 janë prej kuvendit dhe 2 prej ekzekutivit. Një lëshim teknik është bërë, në fund duhet të shtohet edhe emërtimi i parqeve dhe i shesheve.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Atëherë, kërkoj nga partitë politike që t’i japin propozimet e tyre.

Berat Duraku: AAK, e propozojmë Mentor Durgutin!

Lirigzon Kastrati: LDK, e propozojmë zotëriun Nehar Shala!

Defrim Kafexhiu: LVV, e propozojmë Bujar Mustafën!

Flutura Thaqi: PDK, e propozojmë Mirsad Shehun!

Kryesuesi: Na duhet ta respektojmë kuotën gjinore.

Berat Duraku: Atëherë, ne e propozojmë Dafina Gashin!

Kryetari: Nga ekzekutivi, Besmirë Bytyqi dhe Norë Boshnjaku!

Kryesuesi: Meqenëse i kemi 4 propozime dhe nga kuvendit na duhet vetëm 3, atëherë duhet t’i vendosim në votim.

Defrim Kafexhiu: Te forma e votimit është më mire të numërohet vetëm votat “për”, sepse të vota “kundër” kundër kolegut nuk është e preferueshme. Në këtë rast, unë ia jap votën të gjithëve.

Kryesuesi: Kush është “për” Dafina Gashin?... Kundër?... Abstenim?... Kush është “për” Nehar Shalën?... Kundër?... Abstenim?... Kush është “për” Bujar Mustafën?... Kundër?... Abstenim?... Kush është “për” Mirsad Shehun?... Atëherë, në këtë komision do të jenë Dafina Gashi (23), Nehar Shala (25) dhe Mirsad Shehu (23), kurse Bujar Mustafa ka 9 vota “për”. Kush është “për”?... Me 23 vota miratohet ky vendim.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të draft-rregullores për Shërbime Publike 01 nr.2917, i datës 26.10.2018:

Isak Hoti: Përshëndetje kryesues, kryetar dhe delegatë të nderuar. Nëse ju pranoni, ne jemi duke e bërë plotësimin dhe kemi 7 ditë afat që ta dërgojmë materialin në shqyrtim të ligjshmërisë. Nëse dëshironi ta votoni sot këtë pikë, me këto ndryshime ne që do t'i bëjmë, atëherë shkon për ligjshmëri, në të kundërtën duhet ta shfuqizojmë.

Kryesuesi: Faleminderit! Në fillim e ceka që mungon materiali për këtë pikë. Nëse dikush ka dikush diçka, nëse jo, po e vendosi në votim shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimit të draft-rregullores për Shërbime Publike. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 21 vota miratohet pika e shtatë.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e komisionit të ankesave, kundër vendimit të komisionit ad hoc për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe:

Kryesuesi: Në seancën e kaluar kemi diskutuar rreth Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe dhe tani janë paraqitur disa ankesa nga fshati. Sot e kemi formimin e komisionit për t'i shqyrtuar ato ankesa. Në këtë komision kërkohen tre anëtarë.

Berat Duraku: AAK, e propozojmë Lendrit Morina!

Lirigzon Kastrati: Kryesues, në seancën paraprake deklaroam që është komisioni për shqyrtimin e ankesave (komisioni i komunës), por nëse kërkohet tjetër komision, atëherë LDK e propozon Qazim Canën.

Kryesuesi: Lirigzon, kemi menduar që Komisioni i Përhershëm i Komunës mund t'i shqyrtojë këto ankesa, mirëpo nuk ka kompetencë për këto, por vetëm për dhënien e pronave të paluajtshme nga komuna.

Vlora Vucitërna – Qmega: LVV, e propozojmë Defrim Kafexhiun.

Flutura Thaqi: PDK, e propozojmë Behlul Krasniqin.

Kryesuesi: Atëherë, meqë i kemi 4 kandidatë, duhet t'i vendosim në votim.

Defrim Kafexhiu: Unë po tërhiqem!

Kryesuesi: Faleminderit për konstruktivitetin! Atëherë, i kemi 3 propozime: Lendrit Morina, Qazim Cana dhe Behlul Krasniqi, por përsëri nuk e plotësojmë kuotën gjinore. Ju lus që mos të gabojmë.

Berat Duraku: Atëherë, ne e propozojmë Sarandë Salltekun!

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, në këtë komision janë: Sarandë Sallteku, Qazim Cana dhe Behlul Krasniqi. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 21 vota "për" miratohet ky vendim.

9. Shqyrtimi i informatës nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural rreth rregullimit të rrugëve në komunën e Rahovecit për vitin 2025:

Behar Thaqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit dhe ju të pranishëm. Drejtoria e Bujqësisë në bashkëpunim me kryetarin Smajl Latifi, gjatë vitit 2025 ka realizuar punime në rregullimin e 32 rrugëve fushore në territorin e komunës së Rahovecit, me gjatësi prej 24.000 metrash rrugë. Punimet janë zhvilluar duhet u bazuar në nevojat e terrenit. Për stabilizimin e terrenit janë përdorur rreth 22.000 metra kub zhavor të fraksionit 0-120mm dhe rreth 11.000 metra zhavor të fraksionit 0-60mm. Gjithashtu, janë realizuar punime në hapjen e kanaleve në gjatësi prej 1370m. Në materialin tuaj, janë paraqitur në detaje të gjitha të dhënat lidhur me realizimin e punimeve në secilin segment rrugor.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit për informatën! Në seancën e kaluar kam kërkuar informacion rreth intervenimeve që i keni bërë deri më tani në kuadër të Fazës Emergjente që e keni titulluar. Disa fshatra janë vetëorganizuar. E kam parë njoftimin e fshatit Radostë, ku qytetarët kanë kërkuar donacione nga bashkatdhetarët, Krusha e Madhe, Nagaci, Hoça e Brestoci janë fshatra që kanë mbledhur donacione për rregullimin e rrugëve fushore. Në raport deklarave që janë realizuar punime në hapjen dhe zgjerimin e kanaleve në gjatësi totale prej

1370m. Në këtë informatë nuk janë të specifikuara vendet se ku janë bërë këto intervenime. Më qudit fakti që në fshatin Hoçë e Vogël veç një intervenim e kemi pasur gjatë mandatit 4-vjecar, një intervenim të një rruge fushore rreth 500m dhe jo 1000m siç e keni shkruar ju.

Sali Sallteku: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Një vërejtje e vogël për Lirigzonin, jo Radostë por Malësi e Vogël. Është e vërtetë që në fshatin tonë janë punuar shumë rrugë me iniciativën e vetë qytetarëve, por edhe drejtori i Bujqësisë me mundësitë që i ka pasur na ka ndihmuar mjaft dhe besoj që është kryer në punë e madhe aty. Të falënderojmë shumë, drejtor!

Vlora Vuciterna – Qmega: Përshëndetje, unë e kam një pyetje: AMF-ja në Malësi të Vogël pse nuk është duke funksionuar?

Kryesuesi: Sepse ende nuk jemi te pytjet dhe përgjigjet, Vlorë.

Vlora Vuciterna – Qmega: Mirë de, unë e bëra pyetjen!

Behar Thaqi: E ftoj Lirigzonin të na tregojë se, pse nuk është lejuar operatori më i mirë që e ka komuna të fillojë punimet në fshatin Hoçë e Vogël?

Lirigzon Kastrati: Po, është e vërtetë që e kemi thirrë drejtorin që ta sheh gjendjen e rrugëve fushore. Operatori është kthyer dhe qytetarët e Hoçës së vogël nuk kanë pranuar të bëhet intervenimi, sepse me vizitën paraprake me drejtorin jemi pajtuar që të kemi shtrim të zhavorit në rrugën “Zona Operative – Pashtriku”. Operatori ka ardhur vetëm me makineri dhe ka thënë që vetëm duhet të bëjmë gërryerje dhe çdo intervenim i këtij lloji do ta dëmtonte rrugën edhe më shumë. Kjo është arsyeja. Unë e kam ftuar përsëri drejtorin që ta thërras operatorin dhe ta bëjë intervenimin e heqjes së dheut pas vërshimeve në rrugën e “Mileskës” për 20 kamiona me dhe, por nuk ka ardhur dhe jemi detyruar përsëri që vetë ta bëjmë edhe atë intervenim.

Kryetari: I kërkoja leje drejtorit që t’i jap disa sqarime korrekte. E para, ne nuk kemi kontratë për trajtimin e rrugëve fushore edhe pse e kemi në plan të prokurimit, sepse thesari me procedura përmbarimore ka ndërhyrë dhe i ka marrë të gjitha mjetet e drejtorisë së Bujqësisë. E dyta, ne kemi pasur vërshtime dhe situata shumë problematike, më 6 dhe 7 janar të këtij viti. Nga operatori që ka pasur kontratë për rrugë fushore, e cila ka skaduar dhe me mirëkuptimin e tij na ka ndihmuar, e falënderoj publikisht. E njëjta situatë është në Malësi të Vogël dhe në Hoçë të Vogël dhe unë e falënderoj kompaninë “Mendi”, që pa asnjë kompenzim është pajtuar që të na ndihmojë. Nuk mund t’i themi një operatori ekonomik: shtroje rrugën me zhavor, sepse nuk kemi kontratë aktive. Ju jeni marrë vesh me drejtorin dhe drejtori ju ka shpjeguar që nuk ka kontratë për zhavor. Marrëveshja me operatorin ka qenë për ndërhyrje, sepse është vështirësuar gjendja në rrugë fushore dhe unë e di që ata kanë dalur përtej mundësive. Unë i respektoj këshillat e fshatrave, por nuk kemi ardhur këtu që dikush të ketë të drejtë ta përzë një operator, i cili ka ardhur të ju ndihmojë në mënyrë humanitare. Nuk jemi në situatë të mirë, sepse pothuajse në të gjitha kategoritë buxhetore në investime kapitale është marrë buxheti nga thesari, pra, i kanë marrë rreth 3.300.000€ dhe ndërkohë që ende nuk është zbatuar nga ana e ministrisë, vendimi i kuvendit për bartjen e të hyrave.

Lirigzon Kastrati: Kryetar, drejtori është në dijeni dhe duhet ta mirëkuptojmë edhe kërkesën e bujqve që e kanë ndaluar operatorin, sepse sikur të intervengohe, sot bujqit do të kishim më shumë telashe nëse nuk do të shtrohej zhavori. Bujqit e kanë ndaluar operatorin për intervenim, sepse intervenimi pa shavor do të ishte i dëmshëm. Pra, në këtë formë është bërë edhe ndalimi i punës së operatorit.

Kryetari: Unë nuk shpreh shqetësim për ndalesën, por mirëkuptim për kërkesën e bujqve dhe reagimin emergjent të komunës. Më besoni, nëse kemi mundësi, asfalt është mirë ta bëjmë. Mirëpo, gjendjen që e kemi me kontratën kolektive, nuk është e mirë.

10. Vendim për lirim nga pagesa e taksave për leje ndërtimore dhe legalizim:

Albnor Mullabazi: Para jush e keni propozim-vendimin e kryetarit për lirim nga taksa e lejes ndërtimore dhe e legalizimit për objektet e rasteve të banimit social (nënprojekti i ndërtimit të njërive të banimit social). Ne jemi në

një vit të vështirë dhe taksat na duhen, por në këtë rast kërkoj që ta marrim këtë vendim. Për moment i kemi 34 aplikues në ministri dhe 7 prej tyre janë përfitues, 13 janë në listë të pritjes, 3 janë tërhequr dhe 11 janë refuzuar. Neve na duhet një vendim prej kuvendit, që këta persona t'i lirojmë prej pagës së taksës dhe lejes ndërtime.

Defrim Kafexhiu: Si vendim po duket shumë korrekt që t'i dalim në ndihmë këtyre familjeve. A është vendimi veç për këtë kategori që kanë aplikuar tani, apo edhe për ata që do të aplikojnë në të ardhmen? A është ky vendim që në cilëndo kohë, familjet e cënueshme do të jenë të liruar nga kjo taksë?

Albnor Mullabazi: Defrim, vendimi ka të bëjë vetëm me rastet që kanë aplikuar në këtë fazë.

Kryesuesi: Pa dyshim, unë votoj “për”, në mënyrë që t'i dalim në ndihmë këtyre familjeve. Nëse nuk është e paraparë me rregullore për taksa dhe tarifa, a jemi në rregull ligjërisht? E di që vlerësimin e ligjshmërisë e bën MAPL-ja dhe shpresoj që ky vendim do të kalojë dhe sa më shpejt të vazhdojnë procedurat e tjera. Kush është “për”?... Kundër?... Me 20 vota “për” miratohet ky vendim.

11. Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të draft-dokumentit të planifikimit hapësinor “Harta Zonale e Komunës së Rahovecit, 2026-2034”:

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! Sot, para jush e keni vendimin për hapjen e shqyrtimit publik për Hartën Zonale të komunës së Rahovecit, 2026-2034. Ky vendim ka të bëjë me një dokument që për herë të parë në historinë e komunës së Rahovecit po hartohet. Është një dokument strategjik, i cili do t'i hap rrugë investimeve të reja dhe është një mundësi për zhvillim për komunën tonë. Deri në sigurimin e këtij pëlqimi kemi kaluar në shumë sfida e në shumë rrugë të vështira. Mbi 17 muaj kemi pritur në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Gjashtë drafte janë dorëzuar në ministri dhe së fundi kemi qëndruar duke punuar 40 orë në Departamentin e Planifikimit dhe kjo asnjëherë nuk do të arrihej pa ndërhyrjen dhe angazhimin direkt të kryetarit të komunës. Sot, nga ju kërkoj që ta votoni hapjen e shqyrtimit publik dhe të fillojë një kapitull i ri. I ftoj qytetarët që gjatë shqyrtimit publik të kontribuojnë në këtë dokument të rëndësishëm.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Pra, sot kërkohet votim formal në mënyrë që Harta Zonale të vendoset në shqyrtim publik. Gjithashtu, edhe unë i ftoj qytetarët që të marrin pjesë në këto debate publike. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht (22) miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

12. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Kryetari: Disa prej komenteve dhe pyetjeve të bëra në fillim, do t'ju përgjigjem tani. Zona ekonomike mbi Opterushë, me vendim të kuvendit ia ka filluar procedurat në 2004, në kohën kur kryetar i komunës ka qenë i ndjeri, Esat Haxhijaha. Ka pasur shumë përpjekje, por në 2018 me vendim të qeverisë (PAN) është themeluar Zona Ekonomike, përkatësisht parku industrial në Opterushë. Në vitin 2021 është licencuar ajo zonë dhe në 2023 kanë filluar procedurat e prokurimit nga ana e Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë. Është lidhur kontratë për fazën e parë dhe kemi nënshtruar memorandum për bashkëfinancim (Kiesa), pra me 20% të mjeteve. Që me vendosjen e gurëthemelit, unë i kam pasur dilemat e mia të bazuara, sepse operatori ka qenë fiktiv. Ministrja atëherë më ka thënë që në vitin e ardhshëm e përurojmë fazën e parë, bile do t'ja japësh fjalën në Hardh-fest. I thash që kjo punë nuk ndodh, mirëpo fjalën e merr. E ka marrë fjalën, mirëpo nuk ka pasur asnjë lloj lajmi të mirë. Operatori shpejt është dorëzuar. Gabimi i dytë i ministrisë është që kanë lidhur kontratë për fazën e dytë, ende pa i përfunduar punët në fazën e parë. Tutje, ka ndodhur shpëputja e kontratës dhe anulimi i të gjitha procedurave, si dhe 262.000€ i ka dhënë komuna e ministria me gjasë 1.5 milionë. Këto që po i them këtu, ia kam thënë edhe ministres së re në detyrë, Mimoza Kusarit dhe më ka thënë që ka fundi i qershorit pritet të rihapet procedura e prokurimit dhe nëse është e vërtetë ajo që Mimoza e ka thënë, atëherë jemi në pritje të zhvillimeve. Aty janë 34 ha e 98 ari dhe plani është i detajizuar. Në cilësinë e kryetarit të komunës, asnjëherë nuk do të mungojë ndërhyrja ime në ministri, që aty të përfundohet puna.

Sali Sallteku: Kryetar, një herë parku i zonës ekonomike në Operushë ka që në vend joadekuat. Në atë vend lavërdi ka pasur veç Suhareka, sepse për komunën e Rahovecit nuk ka asnjë vlerë. E dyta, ato pare afër 2 milionë qenkën vjedhur të gjitha, mesiguri më së shumti këta të VV-së. Kryetar, a ka mundësi që dy herë në javë ta kemi një mjek në ambulanten e Malësisë së Vogël, sepse jemi mbi 4000 banorë? Shumica jemi të moshuar dhe nëse keni mundësi për këtë gjë, atëherë na bënë nder neve dhe fshatit. Një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: e përmendëm kanalizimin dhe ndriçimin. Drejtor, kanalizimi pak ka telashe me fshatin Gexhë dhe nëse e lidhë, i bën nder bizneseve dhe mbi 20 familjeve. Të lutem, merre këtë iniciativë. Sa i përket ndriçimit, nuk janë shumë, janë vetëm 300m. E katërta, a ka ndonjë rrugicë që rregullohet në fshatin tonë për këtë vit?

Defrim Kafexhiu: Kryetar, po e kuptojmë kohën që jemi në fushatë zgjedhore dhe vazhdimisht thua që nuk bën politikë këtu, por kjo ishte puro politikë. Puna e zonës industriale, për të cilën e keni marrë pëlqimin prej kohës së PAN-it, po e harron një gjë: je kryetar i komunës mbi 10 vjet dhe zona industriale e ka gjendjen e njëjtë. Temë tjetër është ajo se si mundohesh ta gjuash përgjegjësinë, por ju jeni kryetar i komunës që 10 vite dhe përgjegjësia duhet të mbetet te ti. The që 260.000 euro të taksapaguesve tanë ka shkuar dëm. Kjo nuk është e vërtetë, sepse aty është punuar diçka. Meqenëse ju e paskeni ditur që kompania e parë ka qenë fiktive sipas asaj që the, atëherë pse ia keni dhënë paratë? Nëse kjo shkelje është bërë me vetëdije, atëherë përsëri përgjegjësia mbetet te ju për këto 260.000€. Nuk është zgjidhje vetëm t'i kërkojsh procedurat e prokurimit, ndoshta edhe unë do të pajtohesh që komuna t'i ketë procedurat e prokurimit, shkaku i volumit më të vogël të punëve që i ka, por kjo nuk është zgjidhje. Kam dëshirë të na tregosh se sa para janë investuar në zonën industriale, përgjatë kohës prej vitit 2019? Do të thotë që këto 260.000€ nuk janë të vetmet që komuna i ka shpenzuar aty. Nëse komuna i ka shpenzuar këto para, gjendje nuk është që nuk është bërë asgjë, sepse të paktën nivelizimi i terrenit është në rregull dhe mund t'i hap rrugë kontratës së re që do të nënshkruhet. E kam edhe një pyetje për drejtorin që e propozoi vendimin për pëlqim për konsultimin publik të Hartës Zonale: një vendim që e kemi marrë në seancën e kaluar (projekt-rregullorja për kriteret e ndërtimit), a bie poshtë? Një pyetje tjetër: rruga "Dëshmorët e Pashtrikut" është në gjendje të mjerueshme dhe ka shumë ankesa nga qytetarëve. Ku ka mbetur puna e trafos në lagjen "Vëllezërit Frashëri"?

Kryesuesi: Sapo u informova që përsëri kemi telashe me transmetim direkt, a është e vërtetë? Kërkoj nga operatori, përkatësisht nga kryetari që ta diskutojnë këtë çështje, sepse është hera e tretë që nuk kemi transmetim direkt.

Kryetari: Atëherë, shkon vërejtje me shkrim në emër të kryetarit të komunës për operatorin "Ekonomia Online" dhe me të drejt zhvillohet procedura drejt shkëputjes së kontratës. Zonën ekonomike nuk e kam zgjedhë unë, por kuvendi i komunës së Rahovecit. Po, që 10 vjet jam kryetar, por përsëri në kohën time (2018) është themeluar Zona Ekonomike. Të gjitha procedura burokratike për Zonën Ekonomike i kam çka me gjoks. E dyta, po, 3700€ rrafshim dhe 36.000 rrethimi i zones dhe këto janë vepra që kanë ndodhur para se të fillojë projekti, sepse kriteri i parë për një zonë ekonomike janë rrethojat. 262.000€ nuk është që ne ia kemi dhënë operatorit, por ia kemi dhënë ministrisë dhe ministria e cila e ka menaxhimin e këtij projekti, ka thënë paguaja paratë operatorit. Nuk jam prokuror, sepse po të isha, plot prej ministrave do të përfundonin në burgun e sigurisë së lartë. Nuk po bëj fushatë, sepse nëse ministria e bën procedurën siç duhet dhe shpejt, unë publikisht do ta falënderoj. Sot e votuam shqyrtimin publik të Hartës Zonale, një hap shumë i rëndësishëm për zhvillimin e komunës dhe tani për 1 muaj rresht bizneset dhe kategoritë e ndryshme kanë mundësi t'i shtrojnë komentet e tyre rreth hartës zonale. Sa i përket asaj se a është vend i duhur i zonës ekonomike, nuk e kam përcaktuar unë, por e di që ajo zonë ekonomike është peng që 22 vjet. Sa i përket trafos, ata të KEDS-it janë gozhduar që ta marrin një pëlqim nga trafotja që e ka vendosur vetë Florim Shulina, i cili nuk po ua jep pëlqimin, sepse po konsideron se kur e ka vendosur trafon i ka lutur banorët 50% me 50% investim, ata nuk janë përgjigjur dhe kanë besuar që veç KEDS-i duhet ta bëjë. Tani KEDS-i e ka përsipër dhe besoj që zgjidhja ekziston. Nuk e di me datë, por na kanë dhënë shpresë që shpejt do të përfundohet.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Sa për sqarim, kryetari ka 11 vjet, 4 muaj e 19 ditë në pushtet.

Lirigzon Kastrati: Çështjen e parkut të Zonës Ekonomike në Opterushë e ngrita me të vetmen arsye, sepse i njëjti rast pothuajse na ka ndodhur edhe në projektin e shtratit të lumit në fshatin Hoçë e Vogël – Brestoc... (*probleme teknike me operatorin “Ekonomia Online”, si dhe me diktafonin digjital, i cili e bën inzicimin e fjalimeve në kuvend)

Kryesuesi: Nëse dikush tjetër nuk ka diçka për të thënë, atëherë ju falënderoj për kontributin dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



KRYESUESI

Fatmir Iska